

Të shtëna me armë në Podujevë e rrahje me shkop: Lëndohet një person, katër të tjerë shoqërohen në polici

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

21/10/2025 16:07

f

t

l

Në Podujevë janë dëgjuar të shtëna me armë.

Rastin për lajmi.net, e ka konfirmuar zëdhënësja e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

Ahmeti ka thënë se nga ky rast nuk ka persona të lënduar nga arma por se si pasojë e rrahjes një person është lënduar nga një mjet i fort ku edhe është dërguar për trajtimin e nevojshëm mjekësor.

Po ashtu lidhur me rastin policia ka shoqëruar në stacion policor katër persona, prej tyre 1 dëshmitar dhe tre persona të dyshuar të cilët ishin të përfshirë në rast.

“Sot rreth orës 14:30 është pranuar informata për një rrahje dhe shkrepte të armës në Podujevë. Me të marrë informatën policia, ka dalë në vendin e ngjarjes nga ku jemi njoftuar se si pasojë e rrahjes nga një mjet i fortë (shkop) është lënduar një person i cili është dërguar për trajtimin e nevojshëm mjekësor .Aktualisht policia po vazhdon punën për zbardhjen e rrethanave dhe motiveve që karakterizojnë ngjarjen”, ka thënë Ahmeti. **/Lajmi.net/**

LAJME TË FUNDIT

Kurti u ofron britanikëve qendra të azilkërkuesve në...

Zbulohet vlera e bizhuterive të vjedhura nga Muzeu i Luvrit

Muaj të tërë nuk i mjaftuan Kurtit për...

“24heures”: Grupi xhihadist në Zvicër dërgonte para në...

Artikuj të ngjashëm

October 21, 2025

Kurti u ofron britanikëve qendra të azilkërkuesve në Kosovë, kërkon ndihmë...

October 21, 2025

Zbulohet vlera e bizhuterive të vjedhura nga Muzeu i Luvrit

October 21, 2025

Muaj të tërë nuk i mjaftuan Kurtit për t'i bërë numrat...

October 21, 2025

“24heures”: Grupi xhihadist në Zvicër dërgonte para në Kosovë për të...

October 21, 2025

Vajza sulmohet nga ariu në Mamushë, shpëton në momentin e fundit

October 21, 2025

Gjendet pa shenja jete Jashar Jashari që ishte raportuar si i zhdukur